



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1487/4 prot

Datë 05.08.2022

V E N D I M

Nr. 755/2022

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 05.08.2022, shqyrtoi çështjen me:

**Objekt:** Modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit “*Procedurë e hapur*” me Nr. REF-35049-06-30-2022 me objekt “*Blerje dy elektropompa thellësie dhe tre elektropompa drenazhi rezervë për HEC Fierzë dhe HEC Vau Dejës, FV Kompresor i presionit të lartë të ajrit për HEC Vau Dejës dhe pjesëve rezervë për dy kompresorët ekzistues*”, me fond limit 52.000.000 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 01.08.2022 nga autoriteti kontraktor, KESH SH.A (Korporata Elektroenergjitiko Shqiptare).

**Autoriteti Kontraktor:** KESH SH.A (Korporata Elektroenergjitiko Shqiptare)  
Rruga “Viktor Eftimiu”, Nr.12, Tiranë.

**Ankimues:** Operatori ekonomik “MUHOPLUS LTD” SHPK  
Nj.B. 7, Rr. “Ded Gjo Luli”, pall. 2, Shk.2, Ap.4, Tiranë

**Baza Ligjore:** Nenet 30 dhe 115 të ligjit nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”. Neni

4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur,

## Vëren:

### I

#### *Vlerësimi Paraprak*

I.1. Vlëra limit e përllogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

### II

#### *Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 01.07.2022 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “Procedurë e hapur” me Nr. REF-35049-06-30-2022 me objekt “Blerje dy elektropompa thellësie dhe tre elektropompa drenazhi rezervë për HEC Fierzë dhe HEC Vau Dejës, FV Kompresor i presionit të lartë të ajrit për HEC Vau Dejës dhe pjesëve rezervë për dy kompresorët ekzistues”, me fond limit 52.000.000 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 01.08.2022 nga autoriteti kontraktor, KESH SH.A (Korporata Elektroenergjitiko Shqiptare).

II.2. Në datën 12.07.2022 operatori ekonomik “MUHOPLUS LTD” SHPK ka paraqitur ankesë njëkohësisht pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor duke kërkuar modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Bazuar në nenin 112 pika 3 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik” Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës) si dhe ankesën e plotë të ankimuesit.

II.4. Nëpërmjet shkresës nr. 3402/3 prot., datë 15.07.2022, me objekt: “Vendim për shqyrtimin e ankesës për procedurën e prokurimit me objekt: “Blerje dy elektropompa thellësie dhe tre elektropompa drenazhi rezervë për HEC Fierzë dhe HEC Vau Dejës, FV kompresor i presionit të lartë të ajrit për HEC Vau Dejës dhe pjesëve rezervë për dy kompresorët ekzistues”, NR.REF-35049-06-30-2022”, drejtuar operatorit ekonomik “MUHOPLUS” SHPK dhe për dijeni KPP-së, protokolluar me tonën me nr. 1487/2 prot., datë 18.07.2022, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.5. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor rezulton, se ky i fundit ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues “MUHOPLUS LTD” SHPK dhe me shkresën e sipërcituar, e ka njoftuar atë se ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës. Konkretisht në përgjigjen e autoritetit kontraktor rezulton se ky i fundit ka pranuar një prej pretendimeve si vijon: *“2.Në lidhje me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues mbi heqjen/modifikimin e kriterit 2.3.6 ku kërkohet që operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: “Certifikatë testimi për kompresorët e ofertuar, - Certifikatë ose testim i vajit sintetik sipas standardit EC 1272-2008”, pretendimi i ankimuesit qëndron.”*

II.6. Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik me Vendimin Nr. 680/2022, datë 21.07.2022 ka vendosur:

1. *Të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar të ankesës për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur” me Nr. REF-35049-06-30-2022 me objekt “Blerje dy elektropompa thellësie dhe tre elektropompa drenazhi rezervë për HEC Fierzë dhe HEC Vau Dejës, FV Kompresor i presionit të lartë të ajrit për HEC Vau Dejës dhe pjesëve rezervë për dy kompresorët ekzistues”, me fond limit 52.000.000 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 01.08.2022 nga autoriteti kontraktor, KESH SH.A (Korporata Elektroenergjitiko Shqiptare).*
2. *Të vazhdojë procedurën e shqyrtimit në themel për pjesën tjetër të ankesës.*
3. *Kopje e këtij vendimi ti dërgohet Agjencisë së Prokurimit Publik.  
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.*

Komisioni i Prokurimit Publik, pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

## Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimet e ankimuesit për ndarjen në lote të procedurës së prokurimit, me argumentet si vijon: “[...] Nga fjalori i përbashkët i prokurimit/kodi cpv, këto pajisje ndahen në 42123400-1-Kompresorë ajri dhe në 42122139-0-Pompa uji, por autoriteti në dijeni të plotë i ka bashkuar në një procedurë të vetme nën kodin CPV 39300000-5 Pajisje të ndryshme. Fakti që këto pajisje ndahen specifikisht dhe në fjalorin e përbashkët të prokurimit i bën ato të veçanta dhe të ndryshme nga njëra tjetra në aspektin funksional, teknologjik por edhe të produktit përfundimtar që prodhojnë/sjellin. Konkretisht elektropompat e ujit shërbejnë për transportin e ujit nga një nivel në një nivel tjetër dhe rritjen e presionit të tij në linjë për të bërë të mundur proceset e ndryshme, në këtë rast, të Hidrocentraleve. Ndërsa kompresorët e ajrit kanë përdorim tërësisht të ndryshëm. Kompresorët e ajrit përdoren për prodhimin e ajrit të komprimuar me presion të lartë, i cili përdoret, në këtë rast, në HEC Fierzë dhe HEC Vau i Dejës. Pra produkti përfundimtar është i ndryshëm, rrjedhimisht dhe ndërtimi i këtyre pajisjeve është i ndryshëm. Kompresorët e presionit të lartë funksionojnë me lubrifikim me vaj dhe me ftohësa me ajër për çdo shkallë komprimimi, janë të pajisura me separatorë vaji dhe valvula sigurie etj. Pra, për nga ndërtimi dhe struktura dhe komponentët përbërës ka një diferencë të madhe në krahasim me elektropompat e ujit. Gjithashtu edhe standardet e këtyre pajisjeve janë totalisht të ndryshme nga njëra tjetra dhe nuk mund të klasifikohen si të një kategorie/lloji apo familje. Gjithashtu ju bëjmë me dije se nuk ekziston pothuajse asnjë prodhues evropian apo ndërkombëtar i cili i prodhon të dyja këto pajisje si elektropompat ashtu edhe kompresorët, kjo për faktin e ndërtimit krejtësisht të ndryshëm të këtyre dy kategorive të pajisjeve dhe shumë diferencave të tjera teknike ndërtimore siç i kemi shpjeguar edhe më sipër. Sa më sipër mosndarja në lote nga autoriteti kontraktor e procedurës së prokurimit, zvogëlon numrin e shoqërive që do të shfaqin interes për këtë procedurë prokurimi, duke lejuar pjesëmarrjen vetëm një numër të kufizuar operatorësh ekonomikë që disponojnë plotësimin e kritereve për të dy elementët e kësaj procedure prokurimi. Pra ndarja në lote do të stimulonte pjesëmarrje e operatorëve ekonomikë të cilët kanë kapacitetet e nevojshme për të ofruar më së miri shërbimin e kërkuar në një lot të vetëm. Autoriteti kontraktor nuk ka vepruar në përputhje me frymën e LPP-së dhe rregullat e prokurimit publik, duke mosndarë procedurën në fjalë në lote të veçanta për të siguruar një pjesëmarrje sa më të gjerë dhe gjithëpërfshirëse.”, Komisioni vëren se, në njoftimin e kontratës të publikuar në SPE, autoriteti kontraktor ka argumentuar: Lidhur me procedurën për blerjen e elektropompave të drenazhit dhe thellësisë në HEC- Fierze dhe HEC Vau i Dejës, si dhe kompresorit të presionit të lartë gjykojmë që prokurimi vetëm me një lot është më i dobishëm për arsye se:

- Elektropompat dhe Kompresorët klasifikohen të dyja në kategorinë e makinave fluide. Të gjithë produktet kanë në përbërje motore elektrik, sistem monitorimi dhe komandimi.
- Elektromotorret e pompave të thellësisë së drenazhit dhe kompresorët duhet të garantojnë qëndrueshmeri mekanike dhe elektike në cdo kohë, në regjime të sforcuara, etj. Të gjithë mallrat objekt të prokurimit janë pajisje që punojnë në të njëjtat kushte në ambientet e Hidrocentralit ku ka prani të vibrimeve, pluhura dhe prani të fushave elektromagnetike, etj.

- Të gjithë mallrat kanë lidhje të drejtpërdrejtë me sigurinë e operimit të hidrocentraleve respektive.

Gjithashtu në përgjigjen e kthyer ankimuesit nëpërmjet shkresës nr. 3402/3 prot., datë 15.07.2022, autoriteti kontraktor ka argumentuar mosndarjen në lote si vijon: “[...] Sqarojmë ankimuesin se kjo procedurë nuk është ndarë në lote pasi elektropompat dhe kompresorët klasifikohen të dyja në kategorinë e makinave fluide. Të gjithë produktet kanë në përbërje motorë elektrikë asinkron, të cilët transferojnë energjinë elektrike në energji mekanike (Energji potenciale në rastin e kompresorit dhe energji kinetike të lëvizjes në rastin e elektropompave). Elektropompat dhe kompresorët janë pajisje që punojnë në kushte presioni shumë të lartë se ai atmosferik dhe duhet të garantojnë humbje minimale të presionit që të garantojnë kushte optimale të operimit dhe eficiencë të lartë. Mallrat do të jenë pjesë e proceseve teknologjike ekzistuese në HEC-et respektive, të pajisur me sisteme monitorimi dhe komandimi. Elektromotorrët e pompave të thellësisë së drenazhit dhe kompresorët duhet të garantojnë qëndrueshmëri mekanike dhe elektrike në çdo kohë, në regjime të sforcuara, që imponohen nga kushte të veçanta me prurje ujore maksimale dhe prodhim me kapacitet të plotë të agregateve. Të gjitha mallrat objekt prokurimi janë pajisje që punojnë në të njëjtat kushte në ambientet e Hidrocentralit ku ka prani të vibrimeve, pluhura dhe prani të fushave elektromagnetike. Të gjithë mallrat kanë lidhje të drejtpërdrejtë me sigurinë e operimit të hidrocentraleve respektive. Nisur nga më sipër, theksojmë që mallrat kanë natyrë të njëjtë për arsye se kategorizohen në të njëjtin grup të makinave, dhe teknologjia që përdoret për të sjellë produktin përfundimtar, shfrytëzon të njëjtat parime të transformimit të energjisë për të kryer punë (produktin). Nuk mund të merret për bazë argumentimi që këto mallra janë të ndryshme, nga disa detaje teknike, që e specifikojnë pajisjen për procesin teknologjik konkret. Vetë elektropompat mund ti përdorësh në disa lloje procesesh teknologjike, për të rritur presionin e ujit, për të rritur presionin e naftës etj., të cilat janë fluide, dhe në këtë rast elektropompat do të kenë specifikat e veta për secilin proces teknologjik, por kjo nuk do të thotë që elektropompat do të jenë të ndryshme në mënyrë thelbësore. Gjithashtu me frazën ku shpreheni se nuk ekziston thujtë asnjë prodhues europian apo ndërkombëtar i cili i prodhon të dyja si elektropompat ashtu edhe kompresorët, shprehemi të sigurt që kjo nuk është aspak e vërtetë. Pa dashur të citojmë disa emra kompanish të cilat i prodhojnë të dyja këto produkte, rezulton që prodhues të tillë ka shumë si në europë aq më tepër ndërkombëtar. [...]”

III.1.1. Në nenin 39 të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet se:

“1. Autoriteti ose enti kontraktor mund të vendosë të japë një kontratë në formën e loteve të veçanta, duke përcaktuar madhësinë dhe objektin e këtyre loteve.

Autoriteti kontraktor, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rast se vendos të zhvillojë procedurën e prokurimit pa e ndarë në lote, duhet të parashikojë një përcaktim të arsyeve kryesore për këtë vendim, i cili bëhet pjesë e dosjes së tenderit. Ky detyrim nuk zbatohet në rastin e kontratave sektoriale.”


III.1.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues, për ndarjen e procedurës së prokurimit në lote KPP konstaton, se objekti i këtij prokurimi është blerje dhe montim elektropompa thellësie dhe elektropompa drenazhi, si dhe furnizim vendosje kompresor të presionit të lartë të ajrit pjesëve rezervë për kompresorët ekzistues.


Komisioni i Prokurimit Publik thekson se ndarja ose jo, e një kontrate në lote, është një vendim i rëndësishëm që autoriteti kontraktor merr gjatë procesit paraprak të prokurimit, pasi ndikon drejtpërdrejtë në nivelin e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomike në këtë procedurë prokurimi. Kjo bëhet duke mbajtur në konsideratë elemente të tilla si: tregu, konkurrenca e mundshme, vlera e prokurimit, kostot e ekzekutimit të kontratës dhe vështirësia teknike lidhur me ndarjen në lote etj., dhe veçanërisht faktin nëse objekti i kontratës është një punë/shërbim/mall për të cilin ofertuesit janë të pakët. Referuar arsyeve të mosndarjes në lote, KPP vëren, se autoriteti kontraktor është fokusuar në faktin se elektropompat dhe kompresorët klasifikohen të dyja në kategorinë e makinave fluide. Këto pajisje kanë në përbërje motorë elektrikë, sistem monitorimi dhe komandimi dhe duhet të garantojnë qëndrueshmëri mekanike dhe elektrike në çdo kohë, në regjime të sforcuara, etj. Mallrat objekt-prokurimi punojnë në të njëjtat kushte në ambientet e Hidrocentralit ku ka prani të vibrimeve, pluhura dhe prani të fushave elektromagnetike, etj., si dhe kanë lidhje të drejtpërdrejtë me sigurinë e operimit të hidrocentraleve respektive.

KPP gjykon se në kuptim të ligjit kërkohet një analizë e detajuar e vendimit për mosndarjen në lote. Bazuar në karakteristikat dhe specifikat e veçanta të objektit të kontratës që prokurohet, bazuar në mënyrën që është përcaktuar kryerja e furnizimit dhe montimit të elektropompave dhe kompresorëve, si dhe referuar argumenteve të autoritetit kontraktor të cituara në paragrafin “III.1” të këtij vendimi, Komisioni gjykon, se ndarja e procedurës së prokurimit në lote, sipas pretendimit të ankimuesit, mund të vështirësonte menaxhimin dhe ekzekutimin e kontratave dhe shpërndarjen e përgjegjësive duke e komplikuar realizimin me sukses të kontratës, ndërkohë që referuar objektit të kontratës objekt-prokurimi, furnizimi dhe montimi i elektropompave dhe kompresorëve lidhen ngushtësisht me njëra-tjetrën, si dhe janë tërësisht për të njëjtin funksion e qëllim.


Sa më sipër, pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Muhoplus” SHPK, nuk qëndrojnë.

III.2. Lidhur me pretendimet e ankimuesit se: *“Në pikën 2.3.7. të kësaj procedure prokurimi është kërkuar: “**2.3.7** Operatori ekonomik duhet të ketë të ketë në stafin e tij për periudhën Mars 2022 - Maj 2022 minimalisht 3 (tre) inxhinierë të diplomuar në inxhinieri elektrike, mekanike, elektronike të cilët të jenë të certifikuar si më poshtë:*


 *Minimalisht 2 (dy) inxhinier të certifikuar për impiante të presionit të lartë dhe të ulët.*

 *Minimalisht 1 (një) inxhinier elektronik të certifikuar nga prodhuesi për instalimin e sistemit digjital të tarimit të kompresorëve.*

*Në lidhje me kërkesën e mësipërme, gjatë ofertimit ofertuesi duhet të plotësojë në mënyrë të detajuar formularin përmbledhës të vetë deklaramit dhe më pas, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar i pari të paraqesë pranë AK dokumentacionin i cili duhet të përputhet me atë të shprehur në formularin përmbledhës të vetë deklaramit si:*

 *Kontratë pune*

 *Diplome*



 *Formularët E-sig 25 për periudhën Mars 2022 - Maj 2022.”*

*Në përcaktimin e kriterit autoriteti kontraktor kërkon 3 (tre) inxhinierë të diplomuar në inxhinieri elektrike, mekanike, elektromekanike nga të cilët 2 (dy) inxhinier të certifikuar për*




*impiante të presionit të lartë dhe të ulët dhe 1 (një)inxhinier elektronik të certifikuar nga prodhuesi për instalimin e sistemit dixhital të tarimit të kompresorëve dhe për të vërtetuar këtë fakt duhet të paraqesë kontratë pune, diplomë dhe Formularët E-sig 25 për periudhën Mars 2022 - Maj 2022. AK kërkon që inxhinierat e sipërcituar të jenë të certifikuar sipas përcaktimeve të mësipërme por nuk përcakton dokumentacionin ligjor për vërtetimin e certifikimit. Sa më sipër kërkojmë nga AK të përcaktojë kërkesën mbi dokumentacionin ligjor për plotësimin e kërkesës mbi certifikimin e inxhinierëve. Ndërsa për inxhinierin elektronik që kërkohet të jetë i certifikuar nga prodhuesi për instalimin e sistemit dixhital të tarimit të kompresorëve duam të vëmë në dijeni AK dhe KPP që instalimi i sistemit dixhital mund të bëhet nga vetë prodhuesi dhe më shumicën e rasteve është i përfshirë në cmim. Kjo gjë nuk ndikon aspak, madje i jep më shumë garanci AK mbi cilësinë e mirëfunksionalitetin e pajisjeve. Prandaj kërkojmë që të hiqet certifikata nga prodhuesi për instalimin e sistemit dixhital të tarimit të kompresorëve, pasi është një kërkesë e tepërt dhe diskriminon operatorët ekonomikë që këtë shërbim e marrin direkt nga prodhuesi”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:*

III.2.1. Në shtojcën 7 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pika 2.3.7 “Kapaciteti teknik” të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet si më poshtë:

**2.3.7** *Operatori ekonomik duhet të ketë të këtë në stafin e tij për periudhën Mars 2022 - Maj 2022 minimalisht 3 (tre) inxhinierë të diplomuar në inxhinieri elektrike, mekanike, elektronike të cilët të jenë të certifikuar si më poshtë:*

-  *Minimalisht 2 (dy) inxhinier të certifikuar për impiante të presionit të lartë dhe të ulët.*
-  *Minimalisht 1 (një) inxhinier elektronik të certifikuar nga prodhuesi për instalimin e sistemit digjital të tarimit të kompresorëve.*

***Në lidhje me kërkesën e mësipërme, gjatë ofertimit ofertuesi duhet të plotësojë në mënyrë të detajuar formularin përmbledhës të vetë deklaratimit dhe më pas, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar i pari të paraqesë pranë AK dokumentacionin i cili duhet të përputhet me atë të shprehur në formularin përmbledhës të vetë deklaratimit si:***

-  *Kontratë pune*
-  *Diplome*
-  *Formularët E-sig 25 për periudhën Mars 2022 - Maj 2022.*

III.2.2. Referuar procesverbalit “PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM”, të publikuar nga ana e autoritetit kontraktor në Sistemin Prokurimit Elektronik konstatohet, se është dhënë argumentimi lidhur me përcaktimin e kriterit kualifikues të dhënë në pikën 2.3.7 “Kapaciteti teknik” të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, si më poshtë:

**Argumentimi:**

*Kërkesat për punonjësit, janë kërkuar në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, ku me anë të këtij kriteri*

*vërtetohet që operatorët ekonomikë dëshmojnë se kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të objektit të prokurimit. KESH sh.a, duhet të ketë besueshmërinë dhe të kërkojë garanci për realizimin me sukses të kontratës objekt prokurimi, duke përfshirë kërkesat për një staf të kualifikuar.*

*Kriteri i mësipërm lidhet ngushtësisht me Specifikimet teknike për objektin e kërkuar. AK duhet të ketë besueshmërinë dhe të kërkojë garanci për realizimi me sukses të kontratës objekt prokurimi, duke përfshirë kërkesat për një staf të kualifikuar i cili ti përgjigjet më së miri nevojave të kërkuara në këtë procedurë. Kërkesa që Operatori Ekonomik duhet të ketë të punësuar minimalisht 3 (tre) inxhinier të diplomuar degët e inxhinierisë elektrike, mekanike dhe elektronike është një kërkesë në përputhje me objektin e kontratës pasi proceset e zbatimit të saj, referuar kërkesave teknike të përcaktuara në Specifikimet teknike janë specifike.*

**Konkretisht:**

*Inxhinieri elektrike është kërkuar si kriter në mënyrë që Kontraktori të ketë aftësinë e duhur për realizimin me sukses të furnizimeve të cilat parashikohet të realizohen në këtë kontratë, kjo, referuar specifikimeve teknike lind nevoja e inxhinierit elektrik pasi, do të kryhet furnizimi me energji të elektromotorëve që kanë një fuqi të konsiderueshme dhe duhet të merren të gjitha masat teknike për të marrë parasysh efektin termik që shkaktojnë rrymat e mëdha të këtyre motorëve.*

*Inxhinieri mekanike është kërkuar si kriter në mënyrë që Kontraktori të ketë aftësinë e duhur për realizimin me sukses të furnizimeve të cilat parashikohet të realizohen në këtë kontratë, kjo referuar specifikimeve teknike lind nevoja e inxhinierit mekanik pasi do të kryhet furnizimi i pompave dhe kompresorëve të cilat janë pajisje mekanike të kategorizuara si makina fluide. Për këtë arsye është e nevojshme që operatori ekonomik të ketë në stafin e tij inxhinierin mekanik për të bërë të mundur realizimin e kësaj kontrate objekt prokurimi.*

*Inxhinieri elektronik është kërkuar si kriter në mënyrë që Kontraktori të ketë aftësinë e duhur për realizimin me sukses të furnizimeve të cilat parashikohet të realizohen në këtë kontratë, kjo referuar specifikimeve teknike lind nevoja e inxhinierit elektronik pasi, do të kryhet furnizimi i mallrave objekt prokurimi, duke bërë të mundur komandimin e elektromotorëve nga sisteme elektronike dhe digjitale automatike sipas nevojës së procesit teknologjik.*

III.2.3. Referuar përgjigjes së dhënë ankimesit me shkresën nr. 3402/3 prot., datë 15.07.2022, autoriteti kontraktor është shprehur se:

*“Në lidhje me pretendimin e operatorit ekonomik ankimes, mbi modifikimin e kriterit 2.3.7., ku kërkohet përcaktimi i dokumentacionit ligjor për vërtetimin e certifikimit si dhe kërkohet heqja e certifikatës nga prodhuesi për instalimin e sistemit digjital të tarimit të kompresorëve, pasi në shumicën e rasteve instalimi i sistemit digjital mund të bëhet nga vetë prodhuesi dhe kjo është e përfshirë në çmim. Sipas ankimesit kjo kërkesë është e tepërt dhe diskriminon operatorët ekonomikë të cilët e marrin këtë shërbim direkt nga prodhuesi. Në lidhje me këto pretendime të ankimesit sqarojmë se:*

*Dokumentacioni ligjor për vërtetimin e certifikimit është vetë certifikata ndërsa për sa i përket kërkesës së ankimesit për të hequr certifikatën nga prodhuesi për instalimin e sistemit digjital të tarimit të kompresorëve, sqarojmë se: Pohimi se kjo mund të ofrohet nga vetë*



*prodhuesi në shumicën e rasteve nuk përbën një përcaktim ligjor të detyrueshëm për tu zbatuar gjatë zbatimit të kontratës. AK nuk ka asnjë garanci/marrëveshje/përcaktim ligjor që garanton se ky proces do të realizohet nga vetë prodhuesi, në të tilla kushte është gjykuar e arsyeshme që të vendoset një kriter i tillë. Një tjerë arsye lidhet me natyrën e punës dhe nivelin e rëndësisë që ka kompresori lidhur me sigurinë dhe operimin e hidrocentralit. Në rast se kompresori gjatë funksionimit të tij gjatë periudhës së garancisë pëson avari/jep probleme që lidhen me sistemin digjital të tarimit të kompresorëve dhe është e nevojshme që të ndërhyhet nga eksperti përkatës, nëse ky ekspert nuk është i operatorit ekonomik do të shkaktonte në rastin vonesa në marrjen e shërbimit nga prodhuesi, e cila përkthehet në ndërprerjen e punës së hidrocentralit, humbje ekonomike për shkak të mosrealizimit të prodhimit dhe deri në cenim të sigurisë së hidrocentralit. Konkretisht kompresori bën pjesë në një sistem teknologjik që lidhet drejtpërdrejtë me operimin e agregateve, ku bën të mundur sigurimin e presionit të vajit hidraulik që shërben për komandimin e servomotorëve dhe rrjedhimisht komandimin e lopatave të turbinës. Në momentin e instalimit sistemi digjital i vetë kompresorit do të integrohet me sistemin e kontroll-monitorimit të gjithë procesin në fjalë si dhe në përfundim duhet të bëhet kalibrimi i saj. Ky është një proces pune i cili bëhet në vens (on site) për këtë arsye nga AK është kërkuar inxhinier i certifikuar nga prodhuesi për të bërë të mundur realizimin e kontratës në kohë, pa sjellë pengesa nga burimet njerëzore.”*

III.2.4. Në neni 77, pika 1, 2 dhe 4 “Kërkesat për kualifikim” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikon shprehimisht se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

*Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.*

*2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionale ose tregtarë.*

*Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t’u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.*

*4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.*

*Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.*

*Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”.*

III.2.5. Në nenin 41 pika 4 “Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve” të VKM Nr. 285 datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet se: “Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) licenca profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose

b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose

c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose

ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

d) Në rastin e procedurës së prokurimit “Shërbim konsulence”, stafi i angazhuar të paraqesë deklaratë disponueshmërie për kryerjen e shërbimeve që ka marrë përsipër të realizojë.”.

III.2.6. Komisioni i Prokurimit Publik sqaron, se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit ekonomik për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

Komisioni vlerëson, se kriteret e kualifikimit duhet të jenë në përputhje me objektin e prokurimit, natyrën, aftësinë zbatuese, vlerën si dhe përmasat/volumin e kontratës. Në rastin konkret e rëndësishme për autoritetin kontraktor, referuar natyrës së kontratës është realizimi i objektit të prokurimit në përputhje me specifikimet teknike natyrën dhe përmasat e kontratës në fjalë.

III.2.7. Lidhur me pretendimin e ankimuesit se: “ [...] Për inxhinierin elektronik që kërkohet të jetë i certifikuar nga prodhuesi për instalimin e sistemit digjital të tarimit të kompresorëve duam të vëmë në dijeni AK dhe KPP që instalimi i sistemit digjital mund të bëhet nga vetë prodhuesi dhe më shumicën e rasteve është i përfshirë në çmim. Kjo gjë nuk ndikon aspak, madje i jep më shumë garanci AK mbi cilësinë e mirëfunksionalitetin e pajisjeve. Prandaj kërkojmë që të hiqet certifikata nga prodhuesi për instalimin e sistemit digjital të tarimit të kompresorëve, pasi është një kërkesë e tepërt dhe diskriminon operatorët ekonomikë që këtë shërbim e marrin direkt nga prodhuesi”, nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit, vërehet, se autoriteti kontraktor ndër të tjera ka kërkuar që ofertuesit të vërtetojnë se kanë të punësuar në

stafin e tyre [...] minimalisht 1 (një) inxhinier elektronik të certifikuar nga prodhuesi për instalimin e sistemit digjital të tarimit të kompresorëve.

III.2.7.1. Në dokumentet e tenderit, në pikën 2.16. të Njoftimit të Kontratës, nga ana e autoritetit kontraktor është parashikuar si vijon:

**2.16. Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera:**

*Specifikoni nëse autoriteti/ enti kontraktor kërkon që detyra/punë/aspektet kritike të kontratës të përmbushen nga vetë operatori ekonomik ose nga ndonjë prej anëtarëve të bashkimit të operatorëve ekonomikë, për të cilin ofertuesi nuk lejohet të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera.*

**Po**

**X**

**Jo**

**Nëse po, të specifikohet detyra, puna, aspekte kritike, që nuk lejohet mbështetja:**

*Për shkak të rëndësisë dhe konfidencialitetit kërkohet që të kryhet nga një operator i vetëm.*

Pra rezulton se në njoftimin e kontratës autoriteti kontraktor ka zgjedhur opsionin “Po”, dhe më pas është shprehur “Për shkak të rëndësisë dhe konfidencialitetit kërkohet që të kryhet nga një operator i vetëm”. Pra autoriteti kontraktor e ka lënë të paqartë dhe evazive parashikimin për mbështetjen në kapacitetet e subjekteve të tjera, duke krijuar konfuzion tek ofertuesit për përgatitjen e ofertave të tyre sipas parashikimeve të nenin 84 “**Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera**”, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimit publik”, sipas të cilit: 1. Operatori ekonomik, me qëllim plotësimin e kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor në dokumentet e tenderit, mund të mbështetet në kapacitetet ekonomike e financiare, aftësinë teknike ose profesionale të subjekteve të tjera, pavarësisht natyrës juridike të lidhjeve që ai ka me ta. 2. Operatori ekonomik mund ta shfrytëzojë aftësinë e ndonjë subjekti tjetër për të dëshmuar plotësimin e kushteve në lidhje me kualifikimet arsimore dhe profesionale vetëm nëse subjekti tjetër i kryen punët ose do t’i sigurojë shërbimet për të cilat kërkohet aftësi e tillë. 3. Kur një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim. 4. Autoriteti ose enti kontraktor duhet të sigurohet se për subjektin, aftësinë e të cilit e shfrytëzon operatori ekonomik, nuk ekzistojnë shkaqet për skualifikimin ose përjashtimin e tij. Autoriteti ose enti kontraktor duhet t’i kërkojë operatorit ekonomik që të zëvendësojë subjektin që ndodhet në kushtet e skualifikimit apo të përjashtimit. 5. Nëse operatori ekonomik shfrytëzon aftësi nga subjekti tjetër në lidhje me kushtet që kanë të bëjnë me gjendjen ekonomike dhe financiare, autoriteti ose enti kontraktor mund të kërkojë që operatori ekonomik dhe subjekti të ndërmarrin përgjegjësi solidare për zbatimin e marrëveshjes.

Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se autoriteti kontraktor duhet të saktësojë dhe qartësojë parashikimet e tij lidhur me kërkesën për mbështetjen në kapacitetet e subjekteve të tjera duke lejuar që operatorët ekonomikë të interesuar për të marrë pjesë në procedurën e mësipërme të prokurimit, të plotësojnë kërkesën e autoritetit kontraktor për minimalisht 1 (një) inxhinier elektronik të certifikuar nga prodhuesi për instalimin e sistemit digjital të tarimit të kompresorëve nëpërmjet kapacitetit të vetë ofertuesit ose në aftësinë teknike ose profesionale të subjekteve të tjera, pavarësisht natyrës juridike të lidhjeve që ai ka me ta.

Pretendimi i ankimuesit qëndron pjesërisht.

III.2.8. Lidhur me pretendimin e ankimuesit: *“AK kërkon që inxhinierët e sipërcituar të jenë të certifikuar sipas përcaktimeve të mësipërme por nuk përcakton dokumentacionin ligjor për vërtetimin e certifikimit. Sa më sipër kërkojmë nga AK të përcaktojë kërkesën mbi dokumentacionin ligjor për plotësimin e kërkesës mbi certifikimin e inxhinierëve”*, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se në rastin konkret ndodhemi para kërimit për sqarime mbi mënyrën se si do të ofertohej në procedurën e prokurimit objekt-ankimi. Pra, Komisioni gjykon, se objekti i ankesës së operatorit ekonomik ankimues nuk lidhet me kundërshtimin e një vendimi të shprehur nga ana e autoritetit kontraktor (verifikimin ligjor në rast se dokumentet e tenderit janë në përputhje me legjislacionin në fuqi për prokurimin publik), por në thelb është paqartësi mbi dokumentacionin ligjor për vërtetimin e certifikimit, dhe institucionin/et i cili e lëshon këtë certifikatë etj.

KPP gjykon, se autoriteti kontraktor nuk e ka sqaruar ankimuesin me anë të shkresës me nr. 3402/3 prot., datë 25.07.2022, drejtuar operatorit ekonomik ankimues, por vetëm është shprehur se: *“Dokumentacioni ligjor për vërtetimin e certifikimit është vetë certifikata”*. Në këtë kuptim KPP gjykon, se autoriteti kontraktor si organi përgjegjës për hartimin e kriterëve kualifikuese dhe justifikimin për vendosjen e tyre, nuk e ka sqaruar ankimuesin në mënyrë shteruese mbi paqartësitë e tij, si dhe duhet të bëjë dhe publikimin e sqarimit përkatës në sistemin e prokurimeve elektronike në përputhje me nenin 75 të LPP, i cili, parashikon shprehimisht se: *“Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti ose enti kontraktor, i cili duhet t'i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 6 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave. Autoriteti kontraktor ose enti duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t'ua komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit. Në çdo rast, sqarimi i dokumenteve të tenderit nuk do të konsiderohet shtim, pakësim ose ndryshim i kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor në dokumentet e tenderit [...]”*, me qëllim njohjen e të gjithë operatorëve ekonomikë ankimues me sqarimin për dokumentet e tenderit, për të qenë i qartë e i saktë për të gjithë të interesuarit për këtë procedurë prokurimi.

Sa më sipër, pretendimet e operatorit ekonomik ankimues qëndrojnë pjesërisht.

III.3. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues se: *“Në këtë procedurë prokurimi operatori ekonomik për fitimin e kësaj kontrate është i paracaktuar kjo gjë e lidhur ngushtësisht me pikën 2.3.3. dhe shtojcën mbi specifikimet teknike pasi:*

*Në shtojcën 7-Kriteret e veçanta të kualifikimit, AK ka kërkuar:*

*“**2.3.3** Operatori Ekonomik duhet të paraqesë autorizim nga prodhues ose nga distributor të autorizuar nga prodhues, për mallrat e ofruara në këtë procedurë objekt prokurimi.*

Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, e-mail,   b  site kjo e nevojshme p  r Autoritetin Kontraktor n   rast verifikimi nga ana e tij. N   rast se do t   paraqitet autorizim nga distributori i autorizuar nga prodhuesi duhet t   v  rtetohet lidhja midis distributorit t   autorizuar dhe prodhuesit.”

“Sistemi i komprimimit t   ajrit me presion t   lart  , q   p  rb  het nga 3 kompresor   t   presioni t   lart  , 2 kompresor   t   rinj t   furnizuar n   vitin 2017 Bauer tip B.23.4-22 dhe n  j kompresor tip   P80 L i cili momentalisht nuk   sht   n   gjendje pune duke rrezikuar gatishm  rin   e k  tij sistemi i cili   sht   projektuar p  r punimin e 3 kompresor  ve. ...

Krahas pjes  ve t   k  mbimit p  r mir  mbajtje p  r kompresorin e ri, kontraktori do t   furnizoje setin e pjes  ve rezerv   p  r mir  mbajtje, p  rfshire furnizim vendosje dy valvola sigurie 40 bar max., p  r dy kompresor  t ekzistues prodhim t   vitit 2017, sipas list  s n   k  to specifikime.”

#### 6.4.Pjes  t e k  mbimit rezerv   p  r kompresor  t ekzistues

Bashk   me kompresorin e ri duhet t   furnizohen edhe pjes   k  mbimi p  r dy kompresor  t ekzistues

Nr.	P��rshkrimi	Nj��sia	Sasia
1	Vaj lubrifikues(me parametra sipas manualit t�� prodhuesit, ose ekuivalentin e tyre) <b>Vaji Bauer ose ekuivalent</b> <b>Vaji Sintetik no N28355</b>	litra	100
2	Filtra vaji t�� kompresorit	cop��	10
3	Filtra ajri t�� kompresorit	cop��	10
4	Valvolat p��r 3 shkall��t me guarnicionet p��rkat��se (me parametra dhe dimensione sipas manualit te kompresor��ve ekzistues)	komplet	2
5	Guarnicione (O – Rind) t�� ndryshme	set	4
6	Set rripash p��r lidhjen e elektromotorit me kompresorin	set	4
7	Pompe vaji e kompresor��ve, me parametra dhe dimensione sipas manualit te kompresor��ve ekzistues.	cop	2
8	Furnizim valvol sigurie 25-40 bar, me parametra dhe dimensione sipas manualit te kompresor��ve ekzistues.	cop	2

K  rkesa p  r paraqitjen e autorizimit t   prodhuesit sjell n   m  nyr   direkte kufizimin e konkurrenc  s s   lir   sepse AK n   shtojc  n e specifikimeve teknike t   publikuara n   APP ka k  rkuar dor  zimin e pjes  ve rezerv   t   kompresor  ve ekzistues t   vitit 2017 Bauer tip 23.4-22.

Sa m   sip  r n   k  t   procedur   prokurimi, n   dokumentacionin specifikimet teknik en   t   cil  n p  rfshihet dhe lista e pajisjeve/pjes  ve q   do t   furnizohen, p  rcakton se n   k  t   procedur   prokurimi do t   prokurohen dhe pjes   t   k  mbimit rezerv   p  r 2 kompresor   ekzistues: 6.4.Pjes  t e k  mbimit rezerv   p  r kompresor  t ekzistues, bashk   me kompresorin e ri duhet t   furnizohen edhe pjes   k  mbimi p  r dy kompresor   ekzistues (furnizuar n   vitin 2017 Bauer tip B.23.4-22).

N   k  to kushte e vetmja m  nyr   p  r t   v  rtetuar se ofertat e OE-ve p  r pjes  t rezerv   t   kompresor  ve ekzistues jan   realisht n   p  rputhje me kompresor  t ekzistues,   sht   paraqitja e autorizimit t   prodhuesit BAUER.

Autoriteti kontraktor me vendosjen e k  tij kriteri dhe me k  rkes  n p  r blerjen e pjes  ve rezerv   p  r kompresor  t ekzistues, ku ka t   p  rcaktuar qart   modelin e kompresor  ve ekzistues t   cil  t kan   nevoj   p  r k  to pjes   rezerv   dhe asnj   prodhues tjet  r nuk mund t   siguroj   dor  zimin dhe p  rputhshm  rin   e pjes  ve rezerv   p  r n  j kompresor i cili nuk   sht   prodhuar nga vet   ai prodhues, duke kufizuar k  shtu pjes  marrjen dhe konkurrenc  n e

*operatorëve ekonomikë.*

*Për sa më sipër, pjesëmarrja në këtë procedurë prokurimi për blerjen e kompresorëve të ri është e lidhur me autorizimin e prodhuesit BAUER të pjesëve të këmbimit për pjesët rezervë të dy kompresorëve ekzistues (prodhim 2017), pra me operatorin ekonomik me të cilin ka kontraktuar AK në vitet që ka prokuruar kompresorët ekzistues që disponon autorizimin e prodhuesit BAUER. Akoma më tej nga ana jonë është komunikuar me prodhuesin me qëllim realizimin e kriterit të sipërpërmendur për të cilin kompania prodhuese BAUER shprehet se ka vetëm një distributor në Shqipëri.*

*Në këto kushte kërkojmë nga ana e AK:*

- 1. Heqjen e paraqitjes së autorizimit të prodhuesit për pjesët rezervë të kompresorëve ekzistues, pasi është në kundërshtim të plotë me frymën e ligjit për prokurimin publik Ose*
- 2. Heqjen nga lista për prokurim të pjesëve rezervë të dy kompresorëve ekzistues ose ndarjen në lote, duke përfshirë në prokurim vetëm kompresorët e rinj dhe pjesët rezervë të dy kompresorëve ekzistues.”,*

*Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:*

*III.3.1. Në dokumentet e tenderit, shtojca 7, “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, në pikën 2.3.3 “Për Kapacitetin teknik” nga ana e autoriteti kontraktor është përcaktuar kriteri si më poshtë:*

**2.3.3** *Operatori Ekonomik duhet të paraqesë autorizim nga prodhues ose nga distributor të autorizuar nga prodhues, për mallrat e ofruara në këtë procedurë objekt-prokurimi.*

*Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, e-mail, ëbsite kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij. Në rast se do të paraqitet autorizim nga distributori i autorizuar nga prodhuesi duhet të vërtetohet lidhja midis distributorit të autorizuar dhe prodhuesit.”*

*III.3.2. Në nenin 4 “Përkufizime” të ligjit nr.162/2020 Për Prokurimin Publik parashikohet se: “Ekuivalente” është malli ose shërbimi i ofruar me karakteristika të barasvlefshme me ato që janë përcaktuar në specifikimin teknik të objektit të prokurimit”.*

*Në nenin 36 të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikohet shprehimisht se:*

*“Specifikimet teknike, siç përcaktohen në nenin 4 të këtij ligji, duhet të përshkruhen në dokumentet e tenderit. Në specifikimet teknike përcaktohen qartë karakteristikat e punëve, shërbimit ose furnizimit që do të prokurohet.*

*Këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj.*

*Në specifikimet teknike mund të specifikohet edhe nëse do të jetë i nevojshëm transferimi i të drejtave të pronësisë intelektuale.*

*Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve të justifikuara plotësisht, hartohen në mënyrë të tillë që të marrin në konsideratë kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuar ose projektimit për të gjithë përdoruesit, sipas kërkesave në legjislacionin në fuqi.*

*2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.*

*3. Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit ose entit kontraktor, duke iu referuar:*

*a) kërkesave funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t'u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën;*

*b) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve;*

*c) kërkesave në terma funksionale sipas shkronjës "a", referuar specifikimeve teknike sipas shkronjës "b" të kësaj pike, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale;*

*ç) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat "a" dhe "b" të pikës 3 të këtij neni, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët "ose ekuivalenti i tij/saj".*

*4. Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të këtij neni. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët "ose ekuivalente".*

*5. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës "b" të pikës 3 të këtij neni, nuk mund të refuzojë një ofertë me argumentin se punët, furnizimet apo shërbimet për të cilat është dorëzuar oferta nuk plotësojnë specifikimet teknike, të cilave u referohen, për sa kohë që ofertuesi provon në ofertën e tij me çdo mjet të përshtatshëm që zgjidhjet e propozuara përmbushin kërkesat e përcaktuara në specifikimet teknike në mënyrë ekuivalente.*

*6. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës "a" të pikës 3 të këtij neni, ai nuk mund të refuzojë një ofertë për punë, mallra apo shërbime, e cila është në përputhje me standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimet teknike ndërkombëtare, specifikimet teknike të përgjithshme, standardet ndërkombëtare apo sistemet e tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit kur këto specifikime teknike përmbushin kriteret funksionale, të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor."*

III.3.3. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:

*“Qëllim i këtij ligji është:*

- a) të rrisë efijencën dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;*
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;*
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;*
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;*
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;*
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”*

Ndërkohe në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:

- “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.*
- 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.*
- 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”*

III.3.4. Neni 21 pika 1 “Autoriteti ose enti kontraktor” i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon shprehimisht se: *Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj.*

III.3.5. Në neni 77, pika 1 dhe 4 “Kërkesat për kualifikim” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikon shprehimisht se:

*1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

*Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.*

*[...]*

*4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.*



*Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.*

*Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”.*

III.3.6. Në nenin 40 “Kërkesat e veçanta për kontratat e mallrave”, pika 3, 6 dhe 8, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, parashikohet shprehimisht se:

[...]

*“3. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.*

[...]

III.3.7. Referuar kthim-përgjigjes drejtuar ankimuesit rezulton, se autoriteti kontraktor lidhur me pretendimin sa më sipër ka argumentuar si vijon: “Në lidhje me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues, mbi modifikimin e kriterit 2.3.3 ku kërkohet heqja e autorizimit të prodhuesit për pjesët rezervë të kompresorëve sqarojmë se, pjesët rezervë të kompresorëve të cilat janë pjesë e këtij prokurimi, mund të jenë të prodhuesit BAUER siç pretendon ankimuesi, por mund të jenë edhe të prodhuesve të tjerë. Nga ana e AK-së në specifikimet teknike janë paraqitur të gjitha të dhënat teknike të detajuara të kompresorëve ekzistues, gjë e cila bën të mundur që çdo prodhues të bëjë prodhimin e këtyre pjesëve rezervë. Pra operatorët ekonomikë të interesuar mund të marrin autorizimin nga cilido prodhues i kompresorëve. Për të bërë të mundur plotësimin dhe vërtetimin se pjesët rezervë të kompresorëve do të jenë sipas specifikimeve teknike dhe kompatibël me kompresorët ekzistues, AK në kriteret për kualifikim , pika 2.3.9. ka kërkuar që Operatori ekonomik ofertues, duhet të paraqesë një deklaratë që pjesët rezervë të kompresorëve ekzistues të jenë të konfirmuara nga prodhuesi. Pra plotësimi i këtij kriteri do ti japë AK-së sigurinë e cituar më sipër. Gjë e cila kjo do të faktohet në momentin e lëvrimin të mallit.

*Sa i takon pretendimit të ankimuesit se për Shqipërinë përfaqësuesi i kompanisë BAUER është shoqëria “Kledia 06” SHPK, kjo e vërtetuar me email-in bashkëlidhur ankesës, email i cili konfirmon përfaqësimin në Shqipëri, por në këtë email prodhuesi njofton operatorin e interesuar që mund të kontaktojë më përfaqësuesin e tij në vendin tonë. AK në kriterin 2.3.3 ka lënë të hapur mundësinë që operatorët ekonomikë të interesuar, autorizimin e prodhuesit mund ta paraqesin nga prodhuesi ose nga distributori i autorizuar nga prodhuesi. Sa më sipër dhe mbështetur në email-in e dërguar nga prodhuesi, ankimuesi mund t'i drejtohet distributorit të autorizuar për këtë autorizim. Pra ankimuesi dhe cdo operator tjetër i interesuar ka dy mundësi për plotësimin e kriterit 2.3.3.”*

III.3.8. Nga shqyrtimi në tërësi i pretendimit të operatorit ekonomik “Muhoplus” SHPK rezulton, se sipas specifikimeve teknike dhe tabelës 6.4. *Pjesët e këmbimit rezervë për kompresorët ekzistues* autoriteti kontraktor ka kërkuar, autorizim prodhuesi ose distributori të autorizuar nga prodhuesi për mallrat e ofruar, përfshirë këtu edhe pjesët e këmbimit për kompresorët ekzistues. Ndërkohë ankimuesi pretendon, se kjo kërkesë orienton drejt një prodhuesi, duke shmangur konkurrencën.

Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Në lidhje me kundërshtimet e mësipërme të operatorit ekonomik ankimues, mbi modifikimin e kriterit të veçantë të kualifikimit për procedurën e prokurimit objekt-ankimi, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se është me vend të ndalet në një test balancues të dy elementeve kryesore. Së pari nëse kërkesa në fjalë është e përshtatshme për arritjen e synimit të kërkuar dhe së dyti nëse kërkesa në fjalë shkon përtej asaj, se çfarë është e nevojshme për të arritur synimin.

Referuar përgjigjes së autoritetit kontraktor drejtuar ankimuesit, rezulton se është sqaruar, se pjesët rezervë të kompresorëve të cilat janë pjesë e këtij prokurimi, mund të jenë të prodhuesit BAUER, por mund të jenë edhe të prodhuesve të tjerë që plotësojnë treguesit teknike të kërkuar. Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se autoriteti kontraktor duhet të saktësojë dhe të përfshijë në përshtatshme të bërë në specifikimet teknike për këto produkte, mundësinë e paraqitjes së furnizimeve ekuivalente që sigurojnë rezultat të njëjtë, duke përshkruar hollësisht qëllimin për të cilin kërkohen ato, gjë e cila bën të mundur që çdo prodhues të bëjë prodhimin e këtyre pjesëve rezervë që do të përshtaten me ato ekzistues. Në këtë mënyrë autoriteti kontraktor lë të hapur mundësinë e sigurimit të pjesëve të këmbimit dhe produkteve nga prodhuesi origjinal i tyre, por njëkohësisht lejon sigurimin e tyre me treguesit e kërkuar ose ekuivalent edhe nga prodhues të tjerë, rrjedhimisht duke siguruar edhe autorizimet e prodhuesit, sipas burimit të furnizimit. Sipas autoritetit kontraktor në pikën 2.3.9. të kriterëve të veçanta të kualifikimit është kërkuar që operatori ekonomik ofertues, duhet të paraqesë një deklaratë që pjesët rezervë të kompresorëve ekzistues të jenë të konfirmuara nga prodhuesi, për të bërë të mundur plotësimin dhe vërtetimin se pjesët rezervë të kompresorëve do të jenë sipas specifikimeve teknike dhe kompatibël me kompresorët ekzistues, gjë e cila kjo do të faktohet në momentin e lëvrimin të mallit, por kjo gjë duhet lejuar edhe në specifikimet teknike të produkteve në fjalë.

Gjithashtu, AK në kriterin 2.3.3 ka lënë të hapur mundësinë, që operatorët ekonomikë të interesuar, autorizimin e prodhuesit mund ta paraqesin nga prodhuesi ose nga distributori i autorizuar nga prodhuesi.

Sa më sipër Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se autoriteti kontraktor duhet të modifikojë specifikimet teknike për pjesët e këmbimit rezervë për dy kompresorët ekzistues, në përputhje me pikën 4 të nenit 36 të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” sipas të cilit: *“Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose*

*shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të këtij neni. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.*

Gjithashtu sqarimet e dhëna nga ana e autoritetit kontraktor mbi kërkesën për autorizim prodhuesi ose distributorit të autorizuar për pjesët e këmbimit rezervë për kompresorët ekzistues, duhet t’u bëhen me dije edhe të gjithë subjekteve të interesuara për të marrë pjesë në procedurën e prokurimit, në përputhje me nenin 75 të LPP-së i cili parashikon shprehimisht se: *“Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti ose enti kontraktor, i cili duhet t’i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 6 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave. Autoriteti kontraktor ose enti duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t’ua komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit. Në çdo rast, sqarimi i dokumenteve të tenderit nuk do të konsiderohet shtim, pakësim ose ndryshim i kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor në dokumentet e tenderit*

Sa më sipër, pretendimet e operatorit ekonomik ankimes qëndrojnë pjesërisht.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 30 dhe pikat 1 dhe 2 të nenit 115 të ligjit nr. 162/2020 *“Për Prokurimin Publik”*, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, i ndryshuar, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 *“Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*, Neni 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 *“Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”*, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

## **Vendosi**

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Muhoplus” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur” me Nr. REF-35049-06- 30-2022 me objekt *“Blerje dy elektropompa thellësie dhe tre elektropompa drenazhi rezervë për HEC Fierzë dhe HEC Vau Dejës, FV Kompresor i presionit të lartë të ajrit për HEC Vau Dejës dhe pjesëve rezervë për dy kompresorët ekzistues”*, me fond limit 52.000.000 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 01.08.2022 nga autoriteti kontraktor, KESH SH.A (Korporata Elektroenergjitiko Shqiptare).

2. Autoriteti kontraktor të kryejë modifikimet dhe sqarimet përkatëse në përputhje me arsyetimet dhe konstatimet e mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe të publikojë të gjitha ndryshimet dhe sqarimet në Sistemin Elektronik të Prokurimeve.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimues “Muhaplus” SHPK.
5. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

### **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Anëtar**  
**Kreshnik Ternova**

**Anëtar**  
**Anila Malaj**

**Kryetar**  
**Jonaïd Myzyri**